



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI PORTUAL DURRËS
DIVIZIONI JURIDIK**

Nr. _____ Prot.

Durrës, më ____/____/2021

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: "Adenis Kastrati Kastrati" Person Fizik NIPT: L51611004I

Adresa: Tirane Kamez BATHORE Lagjja Nr. 4, Rruga Demokracia, Godina Nr. 29, Kati 1

Procedura e prokurimit: "Procedurën e Hapur te Thjeshtuar – Mallra

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-01768-07-27-2021

Përshkrim i shkurtër i kontratës: "**Bojra Printerash**" 30 (tridhjetë) ditë nga data e nënshkrimit të kontratës

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): jo Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 117 datë 02 Gusht 2021

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. OE "Adenis Kastrati Kastrati" PF ; NIPT L51611004I me vlere 6.864.417 (*gjashtë milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e katërqind e shtatëmbëdhjetë*) lekë, pa tvsh.
2. OE "Ervin Luzi" PF; NIPT K71707007Q me vlere 5.448.800 (pesë milionë e katërqind e dyzet e tetë mijë e tetë qind) lekë, pa tvsh.
3. OE "IT Gjergji Kompjuter" sh.p.k; NIPT K81503063B me vlere 6.099.082 (gjashte milione e nentëdhjete e nente mije e tetëdhjete e dy) lekë, pa tvsh.
4. OE "InfoSoft Office" sh.p.k.; NIPT J62426002Q me vlere 5.097.885 (pesë milionë e nëntëdhjetë e shtatë mijë e tetë qind e tetëdhjetë e pesë) lekë, pa tvsh.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. **OE "Ervin Luzi"** PF; NIPT K71707007Q; me adrese: Tirane Kashar YRSHEK, Lagjja Katund i Ri, Rruga Ali Pashe Gucia, Godina nr.5 me vlere 5.448.800 (pesë milionë e katërqind e dyzet e tetë mijë e tetë qind) lekë, pa tvsh.

Për arsyet e mëposhtëme:

Në dokumentacionin e paraqitur nga ky operator ekonomik, KVO ka evidentuar disa mangësi në plotësimin e kriterëve të kërkuara në Dokumentacionin e Tenderit, si vijon:

1. Në bazë të pikës 2.3.5 të Kriterëve të Vecanta, Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur mostrat sipas parametrave teknik dhe specifikimeve të kërkuara pasqyruar dhe me Procesverbalin përkatës ndërmjet palëve ku:

- a. Mostra Nr.3 "Drum Kyocera Taskalfa 6003i me nr.serial produkti DK 8550" është JO në përputhje me kërkesat e AK.
- b. Mostra Nr.3 "Drum Cartridge Xerox me nr.serial produkti 113R00773" është JO në përputhje me kërkesat e AK.
- c. Mostra Nr.4 "Black Toner Cartridge me nr.serial produkti 106R03623" është JO në përputhje me kërkesat e AK.
- d. Mostra Nr.7 "Lexmark Serial MX517de Drum Unit me nr.serial produkti 50F0Z00,500Z" është JO në përputhje me kërkesat e AK.

Në përfundim të shqyrtimit të të gjithë dokumentacionit të ngarkuar në SPE, rezulton se nuk plotësohen kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe, për rrjedhojë, KVO vendosi të Skualifikojë ofertën OE "Ervin Luzi" Nipt K71707007Q.

2. **OE "IT Gjergji Kompjuter"** sh.p.k; NIPT K81503063B me adrese : Rruga Dervish Hima, Prapa ishTelevizionit Klan, TIRANE; me vlere 6.099.082(gjashte milione e nentëdhjete e nente mije e tetëdhjete e dy) lekë, pa tvsh.

Për arsyet e mëposhtëme:

Në dokumentacionin e paraqitur nga ky operator ekonomik, KVO ka evidentuar disa mangësi në plotësimin e kriterëve të kërkuara në Dokumentacionin e Tenderit, si vijon:

1. Në bazë të pikës 2.3.5 të Kriterëve të Vecanta, Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur mostrat sipas parametrave teknik dhe specifikimeve të kërkuara pasqyruar dhe me Procesverbalin përkatës ndërmjet palëve ku:

- a. Mostra Nr.1 "Xerox Workcenter 5222 Black Toner Cartridge me nr.serial produkti 106R01413" është JO në përputhje me kërkesat e AK.
- b. Mostra Nr.3 "Drum Cartridge Xerox me nr.serial produkti 113R00773" është JO në përputhje me kërkesat e AK.

Në përfundim të shqyrtimit të të gjithë dokumentacionit të ngarkuar në SPE, rezulton se nuk plotësohen kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe, për rrjedhojë, KVO vendosi të Skualifikojë ofertën OE "IT Gjergji Kompjuter" me Nipt K81503063B.

3. OE "InfoSoft Office" sh.p.k.; NIPT J62426002Q me adrese: Koder Kashar, Autostrada Tirane-Durres, Km 8 KASHAR; me vlere 5.097.885 (pesë milionë e nëntëdhjetë e shtatë mijë e tetë qind e tetëdhjetë e pesë) lekë, pa tvsh.

Për arsyet e mëposhtëme:

Në dokumentacionin e paraqitur nga ky operator ekonomik, KVO ka evidentuar disa mangësi në plotesimin e kriterëve të kërkuara në Dokumentacionin e Tenderit, si vijon:

1. Në bazë të pikës 2.3.5 të Kriterëve të Vecanta, Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur mostrat sipas parametrave teknik dhe specifikimeve të kërkuara pasqyruar dhe me Procesverbalin përkatës ndërmjet palëve ku:

a. Mostra Nr.7 "Lexmark Serial MX517de Toner Cartridge Black me nr.serial produkti 51B2X00" është JO në përputhje me kërkesat e AK pasi komisioni evidentoi që barcodi i produktit i stampuar në kutinë e mostrës së sjellë nga OE nuk korrespondonte me check-inin online të skanimit të barcodit më artikullin e kërkuar nga AK.

Sipas dispozitave ligjore të DST-së, pikën 2.3.5 të "Kapaciteti Teknik"; "Kriteret e Vecanta të Kualifikimit" si më poshtë:

"2.3.5. Për vlerësimin e saktë të ofertës teknike dhe origjinalitetit, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë fizikisht mostrat, brenda datës dhe orës së hapjes së ofertave , në zyrën e protokollit brenda godinës së administratës së Autoritetit Portual Durres.

Paraqitja e mostrave duhet te behet per ato zerat e percaktuar ne dokumentin bashkelidhur DST, me emertimin Kriteret kualifikuese - pika 3 "tabela me mostrat qe duhen paraqitur" Këto mostra do të vihen në dispozicion të KVO brenda një kutie me emertimin qartazi sipër tek Emri i Operatorit Ekonomik të shoqëruar me një proces - verbal ku Operatori Ekonomik të ketë listuar të gjithë artikujt e këtij paragrafi, sipas tabelës me sipër.

Mos paraqitja e mostrave ose mospërputhja e parametrave teknik të tyre me specifikimet e kërkuara është kusht skualifikues".

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave shqyrtoi mostrën e dorëzuar me specifikime të kërkuara nga OE "Infosoft Office", përkatësisht mostrën "Lexmark Serial MX517de Toner Cartridge Black me nr.serial produkti 51B2X00" prej ku rezultoi që kutia e dorëzuar i përkiste një tjetër mostre me kod 51B2000 e cila nuk është ajo e kërkuar nga AK nëpërmjet DST por i ishte vendosur një etiketë me kodin e kërkuar nga AK 51B2X00 sipër kodit origjinal.

KVO duke u ndodhur para faktit dhe rrethanave që kemi të bëjmë më tjetërsimin e etiketës dalluese të mostrës dorëzuar dhe zbatimit të detyrimeve ligjore të kërkuara nga AK në DST e shpallur në sistem, si dhe rasteve të ngjashme të shqyrtuara dhe gjykuara në zbatim të ligjit nga KPP sipas vendimeve të shpallura në buletin me nr. K.P.P 671/2019 dhe K.P.P 193/2019.

- *AK vëren se operatori ekonomik "Infosoft Office" ka kryer veprime për modifikimin e mostrës pasi mbi pullën origjinale e cila ka përshkrim "51B2000" ka vendosur një*

etiketë tjetër me përshkrim "51B2X200". AK gjykon se këto ndërhyrje për modifikimin e mostrave janë veprime të paligjshme të cilat nuk mund të kalojnë pa u vlerësuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi dukshëm operatori ekonomik "Infosoft Office" shpk është përpjekur të kryejë veprime manipuluese mbi mostrën e paraqitur duke modifikuar përshkrimin e saktë të saj.

- AK gjykon se dorëzimi i mostrave jo në përputhje me specifikimet teknike përbën shkak për skualifikim në përputhje me nenin 82 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 e ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit. Është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentat e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Akoma më tej AK sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. "

➤ **Për sa më lart është dokumentuar me foto, ku vërehet tjetërsimi i Etiketës.**

Në përfundim të shqyrtimit të të gjithë dokumentacionit të ngarkuar në SPE, rezulton se nuk plotësohen kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe, për rrjedhojë, KVO vendosi të Skualifikojë ofertën OE " InfoSoft Office me Nipt J62426002Q ".

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se oferta e paraqitur nga "**Adenis Kastrati Kastrati**" Person Fizik NIPT: L51611004I; Adresa: Lagjja Nr. 4, Rruga Demokracia, Godina Nr. 29, Kati 1 BATHORE Kamez Tirane, me një vlerë të përgjithshme prej 6.864.417 (gjashtë milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e katërqind e shtatëmbëdhjetë) lekë, pa tvsh, është identifikuar si **oferta e suksesshme**.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik".

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Pirro Vengu